



POZICION I LIRE PUNE (VAKANT)

Buçimas, 01.07.2025/KI

HYRJE

Nehemiah Gateway Albania është Fondacion Jo Fitimprurës, humanitar dhe ushtron aktivitetin e tij prej vitit 1991 në Shqipëri, kryesisht në rrethin e Pogradecit dhe të Gjirokastrës. NG Albania ushtron aktivitetin në fushat e bamirësisë, ndihmesës sociale dhe mjekësore, si edhe të kualifikimeve arsimore, shkencore dhe profesionale, nëpërmjet Shkollës Nehemia dhe Akademisë "Nehemiah Gateway".

Nehemiah Gateway Albania hap Pozicionin e Lirë të Punës si Mësues/e në Matematikë & Fizikë dhe Informatik në Arsimin e Mesëm:

Pozicionin:

Mësues/e Matematike, Fizike & Informatike në Shkollën Nehemia.

Vendndodhja e punës

Nehemiah Gateway Albania,
7304 Buçimas, Rrethi i Pogradecit,
Albania

Kërkesat për këtë punësim

Kandidati duhet:

1. Të identifikohet me vizionin, misionin dhe vlerat e Nehemiah Gateway Albania.
2. Të ketë aftësinë dhe dëshirën për të punuar si pjesë e grupit, me njerëz nga kultura dhe vende të ndryshme.
3. Të përgatitë programin e vet të mësimdhënies si pjesë e kurrikulës dhe programit arsimor të Shkollës Nehemia, si pjesë e orarit, ngarkesave dhe kërkesave që dalin nga ky program.
4. Të realizojë mësimdhënien sipas kërkesave të përgjithshme pedagogjike, por në veçanti sipas kërkesave cilësore dhe sasiore të institucioneve monitoruese, akredituese dhe mbikqyrëse.
5. Të ketë arsimin e Lartë, ose ekuivalentin për mësimdhënien sipas profilit..
6. Të ketë Licencë për ushtrimin e profesionit në mësuesi.
7. Aftësi të mira komunikimi dhe fleksibilitet në orarin e punës (fundjavave, etj).
8. Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 1 vitë pune në profesion.
9. Njohuri të mira në gjuhën angleze, gjuha gjermane përbën vlerë të shtuar
10. Të zotëroje njohjen e programeve baze kompjuterike.

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Zbatimi i qëllimeve, objektivave dhe politikave të Nehemiah Gateway.
- Siguron konfidencialitetin organizativ, institucional dhe për të gjitha komponentët e të dhënave materiale dhe njerëzore, të brendshme dhe të jashtme.
- Njohja, pranimi dhe zbatimi i Vizionit dhe të Misionit të Nehemiah Gateway Albania, dhe për të gjitha Vlerat, që i përkasin.
- Respektimi, vlerësimi dhe mbajtja e qëndrimeve pozitive ndaj të gjithë audiences, që përfitojnë nga Nehemiah Gateway Albania, ndaj partnerëve, aktorëve në hapësirën ku ata veprojnë dhe për të ruajtur një qëndrim pozitiv dhe kujdestarie në interes të N. G. Albania.
- Respektimi i të drejtave, që rrjedhin nga marrëveshjet, rregulloret dhe udhëzimet. Në të njëjtën kohë, të mirëkuptohet qartë se ekziston edhe një fokus primar bamirësie dhe social, - për këtë N. G. Albania kërkon përkushtim shtesë dhe dashamirësi për angazhimet jashtë kornizave kontraktuale dhe të funksioneve, si të parapërcaktuara.

Application / Documents

- Formularin e Aplikimit
(Mund ta tërhiqni dorazi pranë zyrës së burimeve njerëzore)
- CV - Curriculum Vitae
- Kërkesa dhe letra e motivimit
- Fotokopje të kualifikimeve

Afati i fundit për pranimin e aplikimit është: **15 gusht 2025**

Ju mund të na kontaktoni dhe të dërgoni aplikimin dhe dokumentat

- Përmes aplikimit online në faqen tonë të internetit www.nehemiah-gateway.al
- Dorazi në zarf, në sekretarinë pritëse, pranë zyrës administrative
- Nëpërmjet shërbimit postar

Për më shumë informacion rreth Nehemia Gateway Albania kërkoni në faqen tonë zyrtare www.nehemiah-gateway.al